



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS LEPOSAVIQ

---

Numri i lëndës: 2020:127497

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05806651

**P.nr.188/18**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** – Dega në Leposaviq, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Qëndresa Tahiri- Islami, me bashkëpuntoren profesionale Edita Koliqi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit J.R për shkak të veprës penale: Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPRK-se sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP. II.nr 1571/2017 të datës 18.05.2018, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 23.05.2024, me datë 24.05.2024 publikisht shpalli, ndërsa me datë 11.06.2024, përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari:

J.R me nofken “.....” i biri i ..... dhe ....., e gjinisë ....., i lindur më ..... në fshatin Vuca Komuna e Leposaviqit, tani me vendbanim në rr. “....., serb, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal .....

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse:

Deri më datwn 29.06.2016 në fshatin Vucë Komuna e Leposaviqit, në lokalin për ndarjen e rërës pronarë i të cilit është ai, kishte në posedim pushkën me ajër të markës Norinco Model B3/2 të kalibrit 5.5 mm pa dokumentacion dhe licensë përkatëse. në kundërshtim me ligjin për armët neni 4 i Ligjit për armët, e cila gjatë kontrollit të shtëpise i është gjetur në dhomen e tij, dhe e njejta i është konfiskuar.

Me këto veprime ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, (Kodi Penal i Republikës së Kosovës 04/L-082).

Andaj Gjykata në bazë të neneve: 1, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 41, 46, 73, 74 lidhur me nenin 374 par.1 të KPRK-së, dhe neneve: 364, 449, 452 të KPP-së, të akuzuarit, i:

## SHQIPTON

- I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej pesëqind (500) euro, të cilin dënim- gjobë, obligohet ta paguaj brenda afatit prej (15) pesëmbëdhjetë ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se nuk e paguan këtë gjobë, atëherë gjoba do të zëvendësohet me dënim me burgim, siç përcaktohet me nenin 46 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke i 'u përlllogaritur një ditë burgim ekuivalent me 20€ (njëzet euro) dënim me gjobë.
- II. Në mbështetje të nenit 374 par.3 të KPRK-së e lidhur me nenin 276 par.2, nënpar 2.1 të KPP-së, ndaj të pandehurit URDHEROHET, konfiskimi i perhershëm i sendeve: Arma-pushka me ajër të markës Norinco Model B3/2 të kalibrit 5.5 mm. Urdhërohet Policia e Kosovës që armen ta shkatërroj, në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.
- III. OBLIGOHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëzet (20) euro, në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. Kërkesë pasurore-juridike nuk kishte.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP. II.nr 1571/2017 të datës 18.05.2018 kundër të akuzuarve D.T për shkak të veprave penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-se dhe Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-se dhe J.R për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-se të KPRK-se.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale pas dëgjimit të palëve ka vecuar procedurën me Aktvendimin P.nr.188/2018 të datës 23.05.2024, sa i përket pikës I të dispozitivit të aktakuzës dhe atë sa i përket të pandehurit D.T për shkak të veprave penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-se dhe Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-se. Pasi që nga Raporti P.nr.188/18 i datës 01.04.2024 konstatohet se i pandehuri D.T jeton në Serbi dhe gjykata nuk ka mundur ta sigurojë të njejtin.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në çështjen ndaj të pandehurit J.R me datë 23.05.2024, në të cilën ka prezantuar Prokurori i Shtetit Sebahate Sinani, i akuzuari J.R, mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av.Avdi Ademi, si dhe përkthyesi i gjykatës Hysen Mikullovc.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, Gjyqtarja e vetme gjykuese e ka njoftuar të pandehurin lidhur me të drejtat e tij në këtë çështje penale dhe pasi që është bindur se i pandehuri i ka kuptuar udhëzimet e gjykatës, të njëjtit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, ashtu që në këtë seancë i pandehuri lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se ndjehet fajtor dhe se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ngase pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare, dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, konform dispozitave ligjore të nenit 242 të KPP-së, pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të pandehurit J.R, av.Avdi Ademi lidhur me pranimin e fajësisë, i ka propozuar gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë, pasi është bërë në mënyrë vullnetare pas konsulltimit të mjaftueshëm edhe me të si mbrojtës.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i akuzuari, e në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, në këtë drejtim ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të akuzuarin.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2021-SE—094 i datës 21.07.2016, Raporti i Ekspertimit i datës 26.02.2018, lista e sendeve të konfiskuara i datës 29.06.2016, lista e dëshmive nga Njesia e Forenzikës të datës 26.02.2018, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të këtyre provave dhe pranimin të fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke i' u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimin të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lartë, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari ka kryer veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, e për të cilën veprë është paraparë dënimi me me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së. Gjkata, si rrethanë veçanërisht lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale nga i akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar dhe rrethanë tjera lehtësuese faktin se i njejti ka treguar sjellje të mirë në gjykatë, është familjar, baba i katër fëmijëve, pensionist, i gjendjes shëndetësore të dobët ( i është nënshtruar disa operimeve në zemër). Ndërsa, rrethana rënduese gjykata vlerësoj peshën dhe rrezikshmërinë e kësaj vepre penale, faktin se veprat penale të kësaj natyre janë në rritje.

Gjkata vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Gjkata duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 374 par.3 të KPRK-së e lidhur me nenin 276 par.2, nënpar 2.1 të KPP-së, ndaj të pandehurit urdhëroi konfiskimin e përhershëm të Armës-pushka me ajër të markës Norinco Model B3/2 të kalibrit 5.5 mm, e njejta duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës sipas procedurave ligjore në fuqi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 lidhur me par.1 dhe nenit 452 par. 1 të KPPK-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 nën. par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 364, 452, 462 të KPPK-ës, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË- Dega në Leposaviq**

**Departamenti i përgjithshëm- Divizioni Penal**

**P.nr.188/18 të datës: 11.06.2024**

**Bashkëpuntorja profesionale**  
**Edita Koliqi**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese**  
**Qëndresa Tahiri- Islami**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.